



Република Северна Македонија

Министерство за образование и наука



МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS - BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

STANDARDET NACIONALE për arritjet e nxënësve në fund të ARSIMIT FILLOR

Shkup,
mars, 2021

Standardet nacionale për arsimin fillor janë miratuar me vendim nr.
08-4176/2 më 5.3.2021

Milla Carovska, ministre e Arsimit dhe e Shkencës

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
I. SHKRIM-LEXIMI GJUHËSOR.....	5
II. PËRDORIMI I GJUHËVE TJERA	7
III. MATEMATIKA DHE SHKENCAT NATYRORE	9
IV. SKRIM-LEXIMI DIGJITAL.....	14
V. ZHVILLIMI PERSONAL DHE SHOQËROR.....	16
VI. SHOQËRIA DHE KULTURA DEMOKRATIKE	19
VII. TEKNIKA, TEKNOLOGJIA DHE SIPËRMARRËSIA	22
VIII. SHPREHJA ARTISTIKE DHE KULTURA	24

Standardet nacionale për nxënësit e arsimit fillor

Në bazë të kompetencave kryesore për të mësuarit e përjetshëm nga Korniza Evropiane e Referencës, si dhe në bazë të kornizës së kompetencave individuale të zhvilluara nga Komisioni Evropian (për gjuhët e huaja, për kompetencat digjitale, për sipërmarrjen), dhe veçanërisht duke pasur parasysh sistemin dhe njohuritë tona arsimore, shkathtësitë dhe qëndrimet që nxënësit duhet të marrin në arsimin fillor në kontekstin tonë shoqëror, janë përcaktuar tetë fusha të standardeve nacionale në arsimin fillor në vendin tonë. Ato përfshijnë kompetenca transversale dhe / ose kompetenca që lidhen me fusha të caktuara lëndore.



Ato janë:

- I. Shkrim-leximi gjuhësor
- II. Përdorimi i gjuhëve të tjera
- III. Matematika dhe shkencat natyrore
- IV. Shkrim-leximi digjital
- V. Zhvillimi personal dhe shoqëror
- VI. Shoqëria dhe kultura demokratike
- VII. Teknika, teknologjia dhe sipërmarrja
- VIII. Shprehja artistike dhe kultura

Çdo fushë e renditur fillon me një përshkrim të shkurtër të kompetencave specifike për fushën, të ndjekura nga standardet në formën e njohurive dhe shkathtësive (*çfarë di nxënësi/nxënësja dhe / ose mund të bëjë*) dhe qëndrimet / vlerat (*të cilat nxënësi/nxënësja i kupton dhe pranon*). Në fund të secilës fushë jepen udhëzime të shkurtra përmes të cilave, fushat lëndore dhe lëndët mësimore do të fitojnë kryesisht kompetencat nga ajo fushë.

Për të siguruar njohje të mëtjeshme (korniza e referencës), secila njohuri, shkathtësi dhe qëndrim individual është i caktuar me shifër. Një shënim i tillë do të mundësojë që çdo standard, përkatësisht njohuritë / aftësitë dhe qëndrimet individuale të zhvillohen më tej në programet mësimore për secilën lëndë të përcaktuar në planin mësimor (duke përcaktuar rezultatet e të nxënësit, përmbajtjen dhe konceptet, aktivitetet dhe standardet e vlerësimit) dhe njëkohësisht të sigurojë dukshmëri të të njëjtit standard, por nga aspekte të ndryshme, në kuadër të një ose më shumë fushave, në një ose më shumë lëndë mësimore. Disa standarde mund të njihen dhe zhvillohen si në aktivitetet jashtëshkollore ashtu edhe në punën e organizimeve të nxënësve.

Shifrat (kodet) përbëhen nga disa komponentë dhe secili komponent ka kuptimin e mëposhtëm (sipas renditjes së referencës në kod): fusha, lloji i standardit / kompetencës (njohuritë dhe / ose shkathtësitë dhe qëndrimet) dhe numri rendor i njohurive / shkathtësive ose qëndrimit brenda në fushë. Ilustruar përmes shembujve, do të duket në këtë mënyrë:



I. Shkrim-leximi gjuhësor

Kjo fushë përfshin kompetenca që mundësojnë identifikimin, kuptimin, shprehjen, krijimin dhe interpretimin e koncepteve, ndjenjave, fakteve dhe mendimeve me gojë dhe në një larmi formash të shkruara, duke përdorur materiale vizuale, audio / tingullore dhe digjitale në një larmi disiplinash dhe kontekstesh. Këto kompetenca i referohen gjuhës amtare (përkatësisht gjuhës mësimore në të cilën mbahet mësimi) dhe përfshijnë njohuri për lexim dhe shkrim dhe një njohje të qëndrueshme të teksteve të shkruara, zotërim të disa rregullave të fjalorit dhe gramatikës dhe njohuri të funksioneve të gjuhës, si dhe aftësinë për të përdorë llojet kryesore të ndërveprimit verbal në formë gojore dhe të shkruar.

Nxënësi / nxënësja di dhe mund:

I-A.1	t'i shprehë dhe t'i përcjellë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe pikëpamjet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e tyre amtare, përmes mediave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme,
I-A.2	t'i njohë dhe t'i përdor format e ndryshme të shprehjes me shkrim: letrare (poezi, tregim i shkurtër, prezantim / fjalim, ese letrare, ditar, etj.) dhe joletrar (ese tematike, informim, kërkesë, lajmërim për shtyp, reklamë, etj.),
I-A.3	të drejttojë një dialog kritik dhe konstruktiv, duke shprehur pikëpamjet e tij / saj me argumente
I-A.4	të përdorë gjuhën e standardizuar, duke respektuar rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore në shprehjen gojore dhe të shkruar,
I-A.5	të përgatitë dhe të mbajë një fjalim me përmbajtje të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, duke marrë parasysh audiencën (mosha dhe larmia etnike / kulturore),
I-A.6	të identifikojë tiparet themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet, etj.) dhe ngjashmëritë dhe dallimet me gjuhët e tjera,
I-A.7	t'i identifikojë autorët dhe veprat më të rëndësishme të letërsisë në gjuhën amtare,
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve audio: të jetë në gjendje të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionin nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e tij / saj,
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e tij / saj,
I-A.10	të kuptojë përmbajtjen e paraqitur vizualisht (diagrame, tabela dhe grafikë, ilustrime, animacione, etj.): të jetë në gjendje të veçojë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë përmbajtjet e paraqitura vizualisht dhe t'i shpjegojë ato (me shkrim dhe me gojë),
I-A.11	t'i identifikojë dhe analizojë mesazhet dhe elementet stilistikore dhe estetike të veprave letrare,

I-A.12	të përdorë informacionet nga burime dhe media të ndryshme dhe t'i qasen në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur.
--------	--

Nxënësi / nxënësjë kupton dhe pranon që:

I-B.1	përmes mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti gjuhësor dhe kulturor, dhe përmes komunikimit gjuhësor transmetohet trashëgimia kulturore dhe kultura e jetesës,
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste dhe mjedise të ndryshme, dhe në forma të ndryshme, mundësohet komunikim dhe ndërveprim efektiv (gjithmonë duke pasur parasysh me kë zhvillohet komunikimi),
I-B.3	duke lexuar tekste me përmbajtje dhe strukturë të ndryshme, zhvillohet shkrim-leximi, formohet një pamje më e gjerë e vetvetes dhe e botës dhe inkurajohet shkrimi nga nevoja dhe kënaqësia,
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit individual mund të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e komunikimit, por gjithashtu shkaktojnë keqkuptime dhe konflikte,
I-B.5	leximi dhe shprehja e tij në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe inkurajimin e krijimtarsisë dhe të menduarit kritik,
I-B.6	njohja e gjuhës amtare është baza e të mësuarit dhe marrjes së njohurive në të gjitha fushat (lëndët mësimore) të tjera,
I-B.7	njohja e gjuhës amtare është një nga shtyllat më të rëndësishme të identitetit etnik.

Kompetencat për të mësuar gjuhën amtare duhet të zhvillohen dhe fitohen gjatë gjithë arsimit fillor, duke mësuar një lëndë të veçantë - gjuhë amtare (gjuhë maqedonase, gjuhë shqipe, gjuhë turke, gjuhë serbe ose gjuhë boshnjake). Gjithashtu, përvetësimi i kompetencave gjuhësore lidhet me aktivitetet mësimore në lëndët e tjera, veçanërisht në gjuhën angleze si lëndë e detyrueshme dhe në lëndët zgjedhore në fushën e gjuhës, si dhe në shumicën e lëndëve zgjedhore me përzgjedhje të lirë. Sigurimi i shkrim-leximit gjuhësor mbështetet edhe përmes aktiviteteve jashtëshkollore (p.sh., përmes teatrit shkollor).

II. Përdorimi i gjuhëve të tjera

Fusha / lëmia ka të bëjë me kompetencat që sigurojnë përdorimin e duhur dhe efektiv të gjuhëve të tjera të komunikimit. Ajo përfshin komponentët / fushat kryesore të shkrim-leximit: për të kuptuar, shprehur dhe interpretuar koncepte, mendime, ndjenja, fakte dhe mendime në formë gojore dhe të shkruar (duke dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar) dhe në një diametër të përshtatshme të gjuhës që është e ndryshme nga gjuha amtare, pra ndryshe nga gjuha në të cilën ndiqet mësimi.

Gjuhë angleze dhe gjuhë maqedonase për përfaqësuesit e bashkësive të tjera*Nxënësi / nxënësja di dhe / ose mundet:*

II-A.1	të kuptojë fjali dhe fraza të përdorura shpesh që kanë të bëjnë me fushat me rëndësi personale më të menjëhershme (të tilla si informacioni personal, familjar, nevojat dhe interesat),
II-A.2	të nxjerrë pikën kryesore në mesazhe të qarta, të thjeshta, njoftime, udhëzime, kërkesa, etj.,
II-A.3	të lexojë dhe kuptojë tekste të thjeshta të llojeve të ndryshme, në tema të njohura dhe më pak të njohura, të përshtatshme për moshën,
II-A.4	të gjejë informacione specifike në tekste në materiale reale (të tilla si reklama, broshura, udhëzime, broshura, menu, orare/cicerone, etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, në mënyrë që të përballojë situatat nga përditshmëria;
II-A.5	të komunikojë në situata specifike dhe të përditshme kur kërkohet shkëmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i informacionit për tema të njohura,
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe të intonacionit, kur ndonjë parregullsi nuk ndërhyr në komunikim,
II-A.7	të përdorë deklarata dhe fjali të përdorura zakonisht që dalin nga përvoja e drejtpërdrejtë dhe / ose kanë të bëjnë me tema dhe situata me interes të drejtpërdrejtë,
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit,
II-A.9	të respektojë rregullat themelore gramatikore dhe përjashtimet në shprehjen me shkrim dhe me gojë,
II-A.10	të shprehë dhe argumentojë ndjenjat dhe mendimet për gjërat me interes të drejtpërdrejtë,
II-A.11	të përdorë një sërë deklaratash dhe fjalish për të shkruar një mesazh, një letër, një shënim, një kartolinë dhe për të përshkruar me fjalë të thjeshta gjëra me interes të drejtpërdrejtë.

Nxënësi / nxënësja di dhe / ose mundet:

I-A.1	të kuptojë frazat dhe fjalorin e përdorur zakonisht në lidhje me fushat me rëndësi të drejtpërdrejtë personale (p.sh., informacione kryesore personale dhe familjare, blerje, ushqimi, shëndeti, mjedisi),
I-A.2	të kuptojë çështjen kryesore në mesazhe dhe njoftime të shkurtra, të qarta dhe të thjeshta,
I-A.3	të lexojë tekste të shkurtra, të thjeshta dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta brenda një teme të njohur,
I-A.4	të gjejë informacione specifike në materiale të thjeshta të përditshme, të tilla si reklama, prospekte, menu, orare, etj,
I-A.5	të komunikojë në situata të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacionit mbi temat dhe aktivitetet e njohura.
I-A.6	të inicojë dhe marrë pjesë në biseda të shkurtra për një temë të njohur,
I-A.7	të përdorë një sërë frazash dhe fjalish për të përshkruar me fjalë të thjeshta familjen dhe njerëzit e tjerë, kushtet e jetesës, interesat dhe aktivitetet e përditshme,
I-A.8	të shkruajë shënime dhe mesazhe të shkurtra, të thjeshta që dalin nga nevoja e përditshme,

Nxënësi / nxënësja kupton dhe pranon që:

I-B.1	përmes mësimin të një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe është mundësia për komunikim me anëtarët e grupeve të ndryshme kulturore / gjuhësore,
I-B.2	njohja e shumë gjuhëve lehtëson hyrjen në burimet që janë të dobishme për zotërimin e lëndëve / përmbajtjeve të tjera,
I-B.3	mësimi i gjuhëve të tjera zhvillon interes dhe respekt për gjuhë dhe kultura të ndryshme,
I-B.4	përmes mësimin të gjuhëve të tjera zhvillon respekt për kulturat e tjera dhe përmirëson kompetencat ndërkulturore.

Kompetencat për përdorimin e gjuhëve të tjera duhet të zhvillohen dhe të merren gjatë gjithë arsimit fillor. Për këtë arsye, përveç mësimin të gjuhës angleze gjatë gjithë arsimit fillor, nxënësve u ofrohet mundësia të mësojnë një gjuhë të dytë të huaj, të zgjedhur nga lista e gjuhëve të tjera të huaja të ofruara. Arritja e kompetencave gjuhësore nga një gjuhë tjetër e huaj mbështetet, gjithashtu duke përdorur materiale mësimore për të zotëruar lëndë të tjera. Nga

ana tjetër, mësimi i gjuhës maqedonase, si lëndë e detyrueshme për nxënësit që nuk vijnë mësimet në gjuhën maqedonase, por edhe zgjedhja e gjuhës shqipe ose të komunitetit nga lista e lëndëve shtesë të ofruara për nxënësit që ndjekin mësimet në një gjuhë tjetër, përveç e cila është e rëndësishme për përmirësimin e aftësive gjuhësore të nxënësve, gjithashtu mund të konsiderohet veçanërisht e rëndësishme për sigurimin e integritit ndëretnik në shoqëri. Zotërimi i gjuhës maqedonase, gjuhës shqipe ose gjuhës tjetër të komunitetit mbështetet nga organizimi i mëimit të lëndëve zgjedhore dhe aktiviteteve jashtëshkollore në shkolla dygjuhëshe dhe tregjuhëshe, në të cilat është e mundur të zhvillohen aktivitete të tilla me grupe „të përziera“ të nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

III. Matematikë dhe Shkencat natyrore

Kompetencat matematikore tregojnë aftësinë dhe gatishmërinë për të përdorur mënyra të ndryshme matematikore-logjike e të menduarit dhe përfaqësimin numerik dhe hapësinor në zgjidhjen e problemeve të jetës nga përditshmëria. Kompetencat në shkencat natyrore kanë të bëjnë me aftësinë dhe gatishmërinë për të zbatuar njohuritë dhe qasjet e bazuara në prova, në shpjegimin e fenomeneve natyrore dhe përmirësimin e jetës njerëzore, si dhe për të kuptuar ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga ndikimi i aktiviteteve njerëzore në mjedis.

Matematikë

Nxënësi / nxënësja di dhe / ose mundet:

III-A.1	të përdorë radhitjen e operacioneve me numra të plotë, thyesa dhe numra dhjetorë, duke përfshirë kllapat,
III-A.2	të rrumbullakojë numrat në një shkallë të caktuar të saktësisë,
III-A.3	të shqyrtojë zvogëlimin ose rritjen e përqindjes, duke përfshirë probleme të thjeshta me financat personale ose të brendshme, për shembull: interesi (kamata), zbritja, fitimi, humbja dhe tatimi;
III-A.4	të vendosë kur të aplikojë thyesa ose përqindje për të krahasuar sasi të ndryshme,
III-A.5	të rekomandojë / aplikojë përmasë (përpjesëtim) në kontekste të ndryshme nga përditshmëria,
III-A.6	të nxjerr konkluzione kur dy sasi janë drejtpërdrejt proporcionale dhe të përdorë proporcionalitetin në zgjidhjen e problemeve, për shembull kalimi nga një monedhë në tjetrën,

III-A.7	të përdorë grade, shkallë me tregues: zero, numër i plotë pozitiv ose negativ dhe të aplikojë shumëzimin dhe pjesëtimin e gradave me baza dhe shkallë të barabartë, fuqizimi i shkallës, prodhimi dhe herësi,
III-A.8	të thjeshtojë ose të transformojë shprehjet algjebrike dhe të shtojë dhe të zbritë thyesat e thjeshta algjebrike,
III-A.9	të përlllogarisë syprinën dhe vëllimin e formave 3D,
III-A.10	të mbledhë, rregullojë të dhëna diskrete dhe të vazhdueshme dhe të zgjidhë: ekuacionet lineare me koeficientët e plotë; një sistem i dy ekuacioneve lineare me dy të panjohura dhe pabarazive lineare me një të panjohur,
III-A.11	të vlerësojë dhe të kontrollojë zgjidhjet e përafërta të ekuacioneve kuadratike,
III-A.12	të zbulojë karakteristikat e këndeve, drejtëza prerëse, trekëndësha, shumëkëndësha të tjerë dhe një rreth dhe të vendosë cilat karakteristika do t'i përdorë në zgjidhjen e problemeve,
III-A.13	të analizojë format 3D përmes rrjetave dhe parashikimeve,
III-A.14	të gjejë mënyra të përshtatshme për të zgjidhur problemet duke zbatuar teoremën e Pitagorës,
III-A.15	të transformojë forma 2D duke kombinuar: tejbartjen, rrotullimin, simetrinë boshtore dhe ngjashmërinë,
III-A.16	të bëjë dhe të përdorë vizatime në shkallë dhe të interpretojë harta,
III-A.17	të gjejë një vend gjeometrik të pikave në një distancë të caktuar nga një pikë e caktuar ose nga një vijë e caktuar,
III-A.18	të përdorë njësi matëse (gjatësia, masa, vëllimi, sipërfaqja dhe vëllimi) në kontekste të ndryshme,
III-A.19	të llogaritë perimetrin dhe syprinën e formave 2D,
III-A.20	të llogaritë syprinën dhe vëllimin e formave 3D,
III-A.21	të mbledhë, rendit të dhëna diskrete dhe të vazhdueshme dhe të zgjedh intervale të përshtatshme të klasave ku është e nevojshme,
III-A.22	të përfaqësojë të dhëna diskrete dhe të vazhdueshme me: grafikun e linjës për periudhën kohore, diagramet e pikave, diagramin shtyllor, diagramin pemë - fletë,
III-A.23	të interpretojë tabelat, grafikët dhe diagramet, të krahasojë rezultatet dhe të nxjerr përfundime rreth saktësisë së hipotezës,
III-A.24	të vlerësojë një ngjarje, probabilitetin e një ngjarjeje, frekuencën relative dhe të nxjerr përfundime për një eksperiment,
III-A.25	të vendosë si të kontrollojë rezultatet dhe të merr parasysh nëse përgjigjja është e arsyeshme në kontekstin e problemit,
III-A.26	të vlerësojë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe të përmirësojë procesin e zgjidhjes,
III-A.27	të përdorë aplikacione matematikore për të zgjidhur situata të ndryshme problemore dhe për të testuar njohuritë.

Nxënësi / nxënësja kupton dhe pranon që:

III-B.1	çdokush mund të mësojë matematikë nëse punon mjaftueshëm,
III-B.2	njohuritë nga matematika gjejnë zbatimin në shumë lëmi në përditshmërinë jetësore,
III-B.3	njohuritë nga matematika janë të domosdoshme në përvetësimin e njohurive nga lëndë të tjera dhe disiplina shkencore,
III-B.4	të mësuarit e matematikës mund të jetë argëtuese dhe emocionuese.

Shkencat natyrore

Nxënësi / nxënësja di dhe / ose mundet:

III-A.28	t'i përdorë njohuritë themelore shkencore për të shpjeguar botën natyrore,
III-A.29	të shqyrtojë dhe të zgjedhë ide, të vëzhgojë, parashikojë dhe të bëjë supozime (hipoteza), të mbledhë dhe vlerësojë prova, të kontrollojë parashikimet, të planifikojë, të organizojë dhe të kryejë kërkime, të regjistrojë, të përpunojë, të analizojë dhe të paraqesë rezultate, të vlerësojë dhe diskutojë përfundimet,
III-A.30	të organizojë dhe të paraqesë të dhëna sasiore në tabelë, grafikë, diagram dhe skica dhe të interpretojë të dhëna nga fusha të ndryshme, të paraqitura në mënyra të ndryshme,
III-A.31	të kryejë eksperimente të thjeshta duke përdorur pajisje të përshtatshme laboratorike dhe kimikate, të bëjë matje duke përdorur pajisje dhe instrumente të përshtatshme,
III-A.32	të vlerësojë rreziqet në laborator dhe t'i njohë dhe zbatojë masat paraprake dhe rregullat për punën në laborator,
III-A.33	të hulumtojë dhe diskutojë ndikimin e shkencës, teknologjisë dhe aktiviteteve njerëzore në mjedis,
III-A.34	të dallojë dhe klasifikojë substancat dhe për të lidhur përbërjen e tyre me vetitë e tyre,
III-A.35	të njohë njësitë ndërtuese të substancave dhe të bëjë një lidhje midis përbërjes së substancave, strukturës së tyre, lidhjeve kimike në to dhe vetive të tyre,
III-A.36	të dallojë ndryshimet fizike nga ato kimike dhe të identifikojë dhe demonstrojë lloje të ndryshme të ndryshimeve fizike (përfshirë ndryshimet në gjendjen e materies), si dhe lloje të ndryshme të reaksioneve kimike,
III-A.37	të interpretojë dhe të përdorë tabelën periodike të elementeve,
III-A.38	t'i njohë simbolet kimike të elementeve kimike më të rëndësishëm dhe të shkruajë formula kimike duke përdorur valencën,
III-A.39	t'i përfaqësojë reaksionet kimike me ekuacione kimike dhe t'i barazojë ato,

III-A.40	të zbatojë nomenklaturën e llojeve themelore të përbërjeve inorganike dhe disa përbërjeve të rëndësishme organike, t'i paraqesë ato me formula të përshtatshme kimike dhe t'i njohë mënyrat e përfutimit të tyre, vetitë dhe zbatimin e tyre,
III-A.41	të interpretojë energjinë e reaksioneve kimike,
III-A.42	të interpretojë kinetikën e reaksioneve kimike,
III-A.43	të identifikojë dhe të eksplorojë fenomenet në natyrën e gjallë dhe jo të gjallë,
III-A.44	t'i kuptojë bazat e evolucionit dhe faktet themelore në lidhje me origjinën, unitetin dhe biodiversitetin e jetës në Tokë,
III-A.45	të interpretojë strukturën themelore të qelizës dhe të përshkruajë grupimin e qelizave në inde, organe, sisteme organesh dhe organizma;
III-A.46	të përshkruajë dhe të analizojnë proceset themelore fiziologjike (roli dhe funksioni i tyre) që ndodhin në organizmat e gjallë dhe paraqitini ato me ilustrime, skema, diagrame dhe ekuacione,
III-A.47	të zbatojnë njohuritë e proceseve themelore të jetës që ndodhin në nivelin e organizmave në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre,
III-A.48	të identifikojë shenjat themelore të funksionit të dëmtuar të organeve individuale, d.m.th., simptomat themelore të sëmundjes dhe të zbatojë zakone të shëndetshme për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme të organizmit,
III-A.49	të interpretojë rolin e materialit gjenetik në trashëgimi dhe përshkruan procesin e trashëgimisë,
III-A.50	të klasifikojë organizmat e gjallë dhe të shpjegojë strukturën e tyre dhe proceset e tyre fiziologjike,
III-A.51	të shpjegojë ndërveprimin midis njeriut dhe mjedisit dhe të identifikojë ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në mjedis,
III-A.52	të kuptojë rëndësinë dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm dhe të analizojë në mënyrë kritike situatat në të cilat ka konflikte interesi midis nevojës për zhvillim ekonomik-teknologjik dhe mbrojtjes së mjedisit,
III-A.53	të analizojë marrëdhëniet midis sistemeve ekologjike, sociale dhe ekonomike nga niveli lokal në atë global,
III-A.54	të shpjegojë fenomenet fizike dhe të përdorë konceptet shkencore në jetën e përditshme,
III-A.55	të ndërlihdë rregullsitë në eksperiment me rregullsitë në dukurinë reale natyrore, për të perceptuar marrëdhënien shkak-pasojë dhe për të kuptuar se shumë fenomene natyrore mund të parashikohen,
III-A.56	të shpjegojë dhe analizojë lëvizjet dhe efektet e forcës mbi to,
III-A.57	të diskutojë dhe të analizojë format e ndryshme të energjisë në natyrë, shfaqjen dhe transformimin e tyre, proceset e transmetimit dhe mënyrat e përdorimit në civilizimin modern,
III-A.58	të analizojë dhe të paraqesë grafikisht fenomenet e dritës duke përdorur një rreze drite,
III-A.59	të shpjegojë konceptin e ngarkesës elektrike dhe rrjedhës së rrymës përmes qarqeve të thjeshta,
III-A.60	të përshkruajë vetitë e magnetëve,

III-A.61	të analizojë karakteristikat e zërit përmes lëvizjes së grimcave dhe transferimit të energjisë,
III-A.62	të shpjegojë universin dhe sistemin diellor, karakteristikat e planetëve, pozicionin dhe lëvizjen e tyre relative, me theks të veçantë në planetin Tokë,
III-A.63	të identifikojë dhe të krahasojë tiparet gjeografike të kontinenteve, rajoneve dhe vendeve në botë,
III-A.64	të identifikojë tiparet gjeografike të vendit tonë dhe t'i krahasojë ato me vendet e tjera të rajonit, në Evropë dhe në botë,
III-A.65	të bëjë ndërlidhjen e karakteristikave gjeografike të rajoneve me transferimin e botës së gjallë,
III-A.66	të gjejë informacion në lidhje me karakteristikat e zonave gjeografike të paraqitura në harta dhe të përgatitë skica për të treguar zonat gjeografike me karakteristikat e tyre,
III-A.67	të orientohet në hapësirë me ndihmën e skicave, hartave, inçizimeve dhe paraqitjeve digjitale të zonave të dhëna gjeografike.

Nxënësi / nxënësja kupton dhe pranon që:

III-B.5	kurioziteti, sistematizmi dhe inovacioni janë çelësi për zhvillimin e mendimit kërkimor -shkencor,
III-B.6	burimet natyrore të Tokës janë të kufizuara dhe përdorimi i tyre i papërgjegjshëm ka pasoja në cilësinë e jetës,
III-B.7	ngrohja globale shpie në katastrofa natyrore me pasoja për botën e gjallë dhe jo të gjallë në të gjithë planetin,
III-B.8	çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe që ai duhet të zhvillojë vetëdijen mjedisore dhe të veprojë në drejtim të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit,
III-B.9	duhet të kuptojë përparësitë, kufizimet dhe rreziqet e teorive shkencore dhe zbatimin e tyre dhe të tregojë një qëndrim të zhvilluar ndaj marrjes së vendimeve të duhura dhe ndërtimit të vlerave, përfshirë aspektin moral të zgjidhjes së problemit.

Kompetencat matematikore dhe kompetencat në fushën e shkencave natyrore zhvillohen përmes përvetësimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve kryesisht nga lëndët e detyrueshme Matematikë dhe Shkenca Natyrore, të cilat përfaqësohen nga klasa I deri në IX. Për më tepër, përmbajtje që kontribuojnë në marrjen e kompetencave në këto fusha mund të gjenden në listën e zgjedhjeve.

IV. Shkrim-leximi digjital

Në këtë fushë bëjnë pjesë kompetencat që sigurojnë përfshirje aktive në shoqërinë moderne të sofistikuar të informacionit dhe teknologjisë. Ato sigurohen përmes përvetësimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që mundësojnë hapjen dhe njohjen e potencialeve të TIK dhe përdorimin krijues, kritik dhe të përgjegjshëm të TIK për të mësuar, punë dhe aktivitete të tjera personale dhe sociale gjatë arsimit dhe në të ardhmen. Këto kompetenca përfshijnë përdorimin e TIK për qasje në informacion, përdorimin e aftë dhe efektiv të zgjidhjes së problemeve, ndarjen e ideve, komunikimin dhe bashkëpunimin brenda shkollës dhe jetës jashtë shkollës, krijimin e përmbajtjes digjitale, si dhe përdorimin etik dhe të sigurt të teknologjisë digjitale në jetën e përditshme.

Nxënësi / nxënësjë din dhe /ose mund:

IV-A.1	për të hulumtuar dhe krahasuar aftësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe për të vlerësuar, zgjedhur dhe përdorur në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe situatë të veçantë
IV-A.2	për të vlerësuar se kur dhe si për të zgjidhur një detyrë / problem nevojitet përdorimi efektiv dhe efikas i TIK, për të zgjedhur dhe instaluar programet që i duhen, për të përdorur programe mbrojtëse dhe për të zgjidhur problemet rutinë në funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale
IV-A.3	përdor mënyra të ndryshme për të organizuar dhe ruajtur si dhe shpërndarë në mënyrë të sigurt përmbajtjen në pajisje dhe rrjete të ndryshme në mjedisin digjital
IV-A.4	në bashkëpunim me tjerët të analizojë probleme, të zhvillojë ide dhe plan për hulumtimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë se kur dhe për çka do të shfrytëzohet TIK
IV-A.5	përcakton se çfarë informacioni i nevojitet atij / asaj, të gjen, përzgjedh dhe shkarkoni të dhëna digjitale, informatat dhe përmbajtjet, dhe ta vlerësojë rëndësinë e tyre për nevojën specifike dhe besueshmërinë e burimit
IV-A.6	zgjedhin dhe përdorin mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, analizojnë të dhënat dhe paraqesin ato në mënyra të ndryshme duke respektuar rregullat e përdorimit
IV-A.7	zgjedhin dhe përdorin mjetet e duhura të komunikimit TIK, ndajnë në mënyrë të sigurt informatat, kontaktojnë dhe bashkëpunojnë me të tjerët në projekte në internet - online, në aktivitete sociale ose për përdorim personal,
IV-A.8	në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi t'i përdor përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe format digjitale,
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike në sjelljen në hapësirën digjitale,
IV-A.10	të kujdeset për identitetin e vetë digjital, sigurinë dhe reputacionin si dhe t'i respektojë politikat e privatësisë.
IV-A.11	të planifikojë dhe të zhvillojë sekuenca nga instruksione të qarta për realizimin e detyrës konkrete dhe t'i paraqes si algoritëm programor,
IV-A.12	eksplorojnë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitje statike dhe dinamike, tinguj, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta multimediale krijuese me një qëllim specifik dhe për një audiencë të veçantë,

IV-A.13	të definojë kritere për cilësinë e prodhimeve dhe zgjidhjeve digjitale duke e përfshirë inovimin dhe dobinë.
---------	--

Nxënësi /nxënësja kupton dhe pranon se:

IV-B.1	shkrim - leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim,
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë,
IV-B.3	potenciali i TIK-ut do të rritet dhe duhet të monitorohet dhe përdoret, por gjithashtu që duhet të ketë një qëndrim kritik ndaj besueshmërisë dhe ndikimit të të dhënave dhe informatave të disponueshme përmes pajisjeve digjitale,
